# RREGULLORE

# "PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT TË PROMOVIMIT TË PERSONELIT AKADEMIK TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS (KPPA)"

## Neni 1

## Objekti dhe qëllimi

Kjo rregullore ka si qëllim të sigurojë kuadrin e brendshëm rregullues për ushtrimin e veprimtarisë së Komisionit të Promovimit të Personelit Akademik (KPPA), të Universitetit të Tiranës dhe përcakton kompetencat, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të KPPA-së (më poshtë do të quhet Komisioni), si dhe të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të tij.

## Neni 2

## Baza Ligjore

Kjo rregullore hartohet në bazë dhe zbatim të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"

1. Vendimi Këshillit të Ministrave, nr.112, datë 23.02.2018, Për Përcaktimin e Kritereve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë "Profesor i asociuar" dhe "Profesor".

2. Statuti i Universitetit të Tiranës, miratur me Urdhrin nr. 816, datë 26.12.2018 të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

## Neni 3

## Komisioni i Promovimit të Personelit Akademik

Komisioni përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë, të cilët mbajnë titullin "Profesor". Anëtarët e Komisionit vetëkandidohen dhe zgjidhen nga Senati Akademik për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje. Anëtarët e Komisionit zgjedhin kryetarin me votim të fshehtë.

## Neni 4

## Funksioni dhe të drejtat e kryetarit të Komisionit

1. Kryetari zgjidhet nga radhët e anëtarëve të Komisionit, me votim të fshehtë, me shumicë të thjeshtë votash.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI I TIRANËS - REKTORATI-SEKRETARIA

2. Kryetari i Komisionit thërret mbledhjet dhe i drejton ato, cakton rendin e ditës, drejton diskutimet, koordinon punën, siguron zbatimin e ligjit dhe marrjen e vendimeve në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Kryetari cakton ndërmjet anëtarëve të zgjedhur të Komisionit një zëvendës me funksion zëvendësimin e Kryetarit, në rast mungese të tij ose në rast delegimi të drejtimit të Komisionit.

4. Ngre grupe pune për shqyrtimin e problematikave të veçanta që lindin gjatë procesit të punës së Komisionit.

5. Kryetari i Komisionit përfaqëson komisionin në marrëdhënie me të tretët.

**Neni 5**

**Funksioni dhe detyrat e Komisionit**

1. Komisioni funksionon si organ kolegjial, vendimarrës, dhe është përgjegjës për Promovimin e Personelit Akademik.

2. Komisioni kryen detyrat, si më poshtë:

a) Shqyrton dokumentacionin e aplikantëve për titujt akademikë dhe bën vlerësimin e përmbushjes së kritereve

b) Organizon dhe mbikëqyr procedurën e ngritjes dhe të funksionimit të jurisë:

- Ngritja e jurisë për vlerësimin e dokumentacionit të aplikantit kryhet nga Komisioni përmes përzgjedhjes së 5 anëtarëve, ndër 8 propozimet e paraqitura nga njësia kryesore dhe të miratuara nga Rektori i UT-së.
- Komisioni zgjedh prej anëtarëve të jurisë kryetarin e saj, si rregull anëtarin me të vjetër me titullin Akademik më të lartë .
- Anëtarët e jurisë kërkohet të zgjidhen që të mbulojnë fushën e aktivitetit të aplikantit: përkatësisht tre prej tyre të mbulojnë fushën e gjerë të aktivitetit dhe dy të tjerët fushën e aplikuar.
- Anëtarët e jurisë duhet të jenë 3 (tre) nga Universiteti i Tiranës dhe 2 (dy) nga Universitetet të tjera të vendit ose të huaja.
- Juria funksionon si organ kolegjial dhe përgjegjësinë e mban në mënyrë kolegjiale dhe jo individuale.
- Juria, pasi përfundon diskutimin për vlerësimin e aktivitetit shkencor të aplikantit, harton raportin vlerësues, në të cilin shprehet qartë nëse e mbështet kërkesën e aplikantit për titulllin ose nëse e refuzon atë. Raporti vlerësues kërkohet të jetë i argumentuar. Ky raport hartohet sipas formatit që i bashkëngjitet kësaj rregulloreje.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI I TIRANËS - REKTORATI-SEKRETARIA

- Në rastin kur anëtari i jurisë nuk ka të njëjtin vlerësim me pjesën tjetër të saj, ai harton një raport të veçantë, i cili i bashkëngjitet raportit të pjesës tjetër të jurisë.
- Anëtarët e jurisë mbajnë përgjegjësi ligjore dhe etike, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, për vërtetësinë e të dhënave të përfshira në raportin e tyre të vlerësimit.
- Raporti i vlerësimit të jurisë duhet të firmoset në çdo faqe nga të gjithë anëtarët e saj.
- Organizon dhe mbikëqyr procesin e vlerësimit.
- Komisioni vlerëson dokumentacionin dhe procedurat e ndjekura mbi bazën e matricës së miratuar prej tij sipas aneksit bashkëlidhur rregullores.
- Komisioni në vlerësimin e përmbajtjes së dokumentacionit të aplikantit merr në konsideratë edhe raportin e vlerësimit të paraqitur nga juria.
- Komisioni merr vendimin përfundimtar bazuar në vlerësimin e jurisë dhe të dokumentacionit të paraqitur ia përcjell Rektorit të Universitetit të Tiranës.

**Neni 7**

**Konflikti i interesit dhe çështjet e etikës**

1. Në momentin kur anëtari i propozuar për pjesëmarrje në juri konstaton konflikt interesi, ka detyrimin të bëjë deklarimin me shkrim të konfliktit të interesit dhe të kërkojë tërheqjen e kanditaturës së tij.
2. Në rastin kur anëtari i jurisë heq dorë nga anëtarësia në juri, atëherë Komisioni e zëvendëson atë me njërin prej tre anëtarëve të tjerë nga 8 propozimet e paraqitura nga njësia kryesore dhe të miratuara nga Rektori i UT-së.
3. Anëtarët e Komisionit kanë detyrimin të ruajnë konfidencialitetin e diskutimeve dhe debateve të zhvilluara në mbledhjet e Komisionit.

**Neni 8**

**Procedura e shqyrtimit të dokumentacionit**

1. Afati i marrjes në shqyrtim nga Komisioni fillon në datën e dorëzimit të dokumentacionit në Komisionin e Promovimit të Personelit Akademik. Dokumentacioni i aplikantëve shqyrtohet sipas radhës së mbërritjes në komision.
2. Komisioni përzgjedh nga anëtarët e vet dy referentë dhe u vë në dipozicion për shqyrtim dokumentacionin e aplikantit. Referentët paraqesin me shkrim një raport mbi përmbushjen nga aplikanti të kërkesave për titullin dhe një vlerësim përfundimtar.
3. Kur konstaton se dokumentacioni është i plotë, Komisioni vendos për percjelljen e tij për shqyrtim në Juri dhe i paraqet Rektorit të UT-së, kerkesën për dërgimin e emrave të kandidatëve për anëtarë jurie, jo më pak se 8. Komisioni përzgjedh 5 (pesë) anëtarë nga lista e të propozuarve në përbërjen e jurisë.
4. Kur Komisioni konstaton se dokumentacioni i aplikantit është i paplotë ndiqen procedurat e parashikuara në VKM nr.112, datë 23.02.2018.



REPUBLIKA E SHQIPERISE UNIVERSITETI I TIRANES REKTORATI-SEKRETARIA

5. Komisioni diskuton dhe vendos mbi bazën e dokumentacionit të depozituar në dosjen e aplikantit. Pasi dëgjon raportin e dy referentëve dhe diskuton mbi përmbajtjen e dokumentacionit, Komisioni vlerëson nëse dokumentacioni i paraqitur i përmbush kërkesat e VKM nr.112, datë 23.02.2018.

## Neni 9

## Standardet për Titullin Akademik "Profesor i Asociuar"

Standardet për fitimin e titullit akademik "Profesor i Asociuar" përcaktohen në VKM nr. 112 datë 23.02.2018, si vijojnë:

1. Titulli akademik *"Profesor i Asociuar"* i jepet kandidatëve të cilët plotësojnë kriteret ligjore dhe ato të përcaktuara në VKM nr.112, datë 23.02.2018.

2. Aplikimet për fitimin e titullit akademik "profesor i asociuar" kryhen nga anëtarët e personelit akademik të kategorisë "Lektor".

3.Personeli akademik i kategorisë "lektor" aplikon për fitimin e titullit akademik "profesor i asociuar" të paktën 5 (pesë) vjet, nga data që ka mbrojtur gradën shkencore "doktor".

4. Personeli akademik me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme, që aplikon për titullin "profesor i asociuar", duhet:

a) të ketë zhvilluar një cikël të plotë leksionesh për së paku, një lëndë, për 3 (tri) vite akademike;

b) të ketë përvojë pune si personel akademik me kohë të plotë për një periudhë, së paku, 5-vjeçare (pesëvjeçare), me apo pa ndërprerje ose me kohë të pjesshme si lektor, për një periudhë 8-vjeçare (tetëvjeçare) akademike, me apo pa ndërprerje, pas fitimit të gradës shkencore "doktor";

c) Të jetë i aftë të mbajë leksione në një nga pesë gjuhët e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian: angleze, frënge, gjermane, italiane, spanjolle ose të mbrojë veprimtarinë kërkimore botuese përpara Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik, në një nga gjuhët e mësipërme, në përputhje me statutin dhe rregulloren e IAL-së.

5. Personeli akademik, që aplikon për titullin "profesor i asociuar", duhet të shfaqë zotërim të plotë të fushës së tij kërkimore, e cila reflektohet në realizimin e detyrimeve të mëposhtme:

a) Ka botuar, së paku, 5 (pesë) artikuj shkencorë në revista shkencore brenda vendit ose ndërkombëtare të indeksuara. Së paku, 2 (dy) prej artikujve të jenë botuar në revista ndërkombëtare me faktor impakti, të rankuara nga *Thomson Reuters* dhe/ose *Scopus*. Kur këta artikuj janë në bashkautorësi, kandidati duhet të jetë autori i parë ose i dytë. Kandidati duhet të jetë autor i vetëm ose i parë në, të paktën, 2 (dy) artikuj shkencorë të paraqitur për fitimin e titullit;

b) Ka realizuar si autor i parë, së paku, 5 (pesë) referime, nga të cilat, së paku, 2 (dy) janë mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres) në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuara në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në "*Proceedings*", të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI I TIRANËS REKTORATI-SEKRETARIA

6. Kur kandidati paraqet monografi, e cila përmbush kriteret e mëposhtme, ai përjashtohet nga detyrimet e përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b", të pikës 4, të këtij kreu, sipas ekuivalentimit që vijon:

a) Botimi i 1 (një) monografie shkencore, pas fitimit të gradës shkencore "doktor", brenda ose jashtë vendit, e cila duhet të përmbushë kushtet e origjinalitetit dhe duhet të jetë vlerësuar në përmbajtje si punim shkencor nga, të paktën, 2 (dy) vlerësues të pavarur të fushës kërkimore-shkencore dhe të jetë pranuar nga njësia bazë, që mbulon fushën e kërkimit. Monografia shkencore e botuar jashtë vendit konsiderohet e vlefshme nëse shtëpia botuese është e rankuar nga *SENSE Ranking of Academic Publishers,* në kategorinë A, B, C ose D.

Monografitë konsiderohen të ndryshme ndërmjet tyre kur ndryshojnë në përmbajtje me, të paktën, 70%. Monografia e botuar brenda vendit duhet të jetë e vlerësuar në përmbajtje si punim shkencor nga, të paktën, 2 (dy) "profesorë" të fushës kërkimore-shkencore, nga të cilët, të paktën njëri prej tyre duhet të jetë nga vendet anëtare të BE-së, OECD-së ose G20-ës.

b) Monografia e botuar brenda vendit ekuivalentohet me:

i) 2 (dy) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore brenda vendit;

ii) 1 (një) artikull shkencor, të botuar në revistë shkencore ndërkombëtare me faktor impakti.

c) Monografia e botuar jashtë vendit ekuivalentohet me:

i) 4 (katër) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore brenda vendit;

ii) 2 (dy) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore ndërkombëtare me faktor impakti.

7. Për efekt të promovimit akademik, institucionet e arsimit të lartë marrin në konsideratë angazhimin dhe pjesëmarrjen e kandidatit, pas fitimit të gradës shkencore "doktor", në:

a) komitete shkencore apo redaktuese;

b) veprimtari vlerësuese si anëtar komiteti shkencor apo redaktues për llogari të periodikëve ose joperiodikëve shkencorë;

c) projekte kërkimore-shkencore në nivel drejtuesi, koordinatori ose anëtari;

ç) përfitimin e financimeve me bazë konkurrimi në nivel kombëtar e ndërkombëtar;

d) projekte të financuara nga programe me donatorë të huaj, të cilat sjellin përfitime për institucionin, në rolin e koordinatorit të projektit;

dh) vlerësimet e projekteve kërkimore kombëtare ose ndërkombëtare;

e) si drejtues në komitetet organizuese të konferencave shkencore kombëtare ose ndërkombëtare;

ë) projektet e transferimit teknologjik të patentave.

8. Angazhimi dhe pjesëmarrja e kandidatit në një ose disa veprimtari të përcaktuara në pikën 7, të këtij kreu, mund të ekuivalentohet me:

a) 1 (një) artikull shkencor, të botuar në revistë shkencore ndërkombëtare me faktor impakti;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI I TIRANËS REKTORATI-SEKRETARIA

b) 1 (një) artikull shkencor, të botuar në revistë shkencore brenda vendit dhe 2 (dy) referime mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres), në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuara në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në "*Proceedings*", të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.

9. Niveli sasior i treguesve, të përcaktuar në pikën 7 të këtij kreu, si dhe vlera përkatëse e tyre

parashikohen në rregulloren përkatëse të IAL-ve dhe vendosen në funksion të prioriteteve akademike e strategjike të tyre. Raporti për angazhimin dhe pjesëmarrjen për veprimtaritë e parashikuara në pikën 7 të këtij kreu, hartohet nga njësia bazë e njësia kryesore dhe miratohet nga Komisioni për Promovimin e Personelit Akademik.

10. Në rastet kur kandidati ka realizuar studim postdoktoratë në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, me një kohëzgjatje, të paktën, 6 (gjashtë) muaj, shoqëruar me raport të detajuar për aktivitetin kërkimor-shkencor të zhvilluar gjatë kësaj periudhe, ai ekuivalentohet me 1 (një) artikull shkencor të botuar në revistë shkencore ndërkombëtare me faktor impakti dhe 1 (një) referim të mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres) në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuara në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në "*Proceedings*", të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.

11. Për fitimin e titullit akademik "profesor i asociuar", botimet shkencore të vlefshme janë ato të realizuara pas mbrojtjes së gradës shkencore "doktor", deri në datën e dorëzimit të dosjes së aplikimit për titullin akademik "profesor i asociuar".

## Neni 10

## Standardet për Titull Akademik "Profesor"

Standardet për fitimin e titullit akademik "Profesor" përcaktohen në VKM nr. 112 datë 23.02.2018, si vijojnë:

1. Titulli akademik *"Profesor"* i jepet kandidatëve të cilët plotësojnë kriteret ligjore dhe ato të përcaktuara në VKM nr.112, datë 23.02.2018.

2. Personeli akademik, i cili ka titullin akademik "profesor i asociuar", aplikon për fitimin e titullit akademik "profesor", të paktën, 5 (pesë) vite pas fitimit të titullit akademik "profesor i asociuar".

3. Personeli akademik me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme, që aplikon për titullin akademik "profesor", duhet:

a) të ketë qenë titullar lënde ose moduli dhe udhëheqës i veprimtarisë shkencore për një periudhë jo më të shkurtër se 5 (pesë) vite akademike;

b) të jetë ose të ketë qenë i punësuar si personel akademik me kohë të plotë si lektor për një periudhë 8-vjeçare (tetëvjeçare) akademike, pas fitimit të gradës shkencore "doktor", ose me kohë të pjesshme, si lektor, për një periudhë 12-vjeçare (dymbëdhjetëvjeçare) akademike pas fitimit të gradës shkencore "doktor";

c) të ketë udhëhequr, të paktën, 2 (dy) doktorata, të përfunduara. Në rast se kandidati ka ushtruar



REPUBLIKA E SHQIPERISE UNIVERSITETI I TIRANES REKTORATI-SEKRETARIA

veprimtarinë e tij akademike shkencore pranë një njësie kryesore me më pak se 40 (dyzet) veta personel akademik me kohë të plotë, në momentin e aplikimit të ketë udhëhequr, të paktën, 1 (një) doktoratë të përfunduar;

ç) të jetë i aftë të mbajë leksione në një nga pesë gjuhët e Bashkimit Evropian: angleze, frënge,

gjermane, italiane, spanjolle ose të mbrojë veprimtarinë kërkimore-shkencore përpara Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik në një nga këto gjuhë, në përputhje me statutin dhe rregulloren e IALsë.

4. Personeli akademik, i cili aplikon për titullin "profesor", duhet të shfaqë zotërim të plotë të fushës së tij kërkimore, e cila reflektohet në realizmin e detyrimeve, si më poshtë vijon:

a) Ka botuar, së paku, 7 (shtatë) artikuj shkencorë, të botuar në revista shkencore, brenda vendit ose ndërkombëtare të indeksuara. Së paku, 3 (tre) prej artikujve të jenë botuar në revista shkencore ndërkombëtare me faktor impakti, të rankuara nga *Thomson Reuters* dhe/ose *Scopus*. Kur këta artikuj janë në bashkautorësi, kandidati duhet të jetë autor i parë ose i dytë. Kandidati duhet të jetë autor i parë në, të paktën, 4 (katër) artikuj shkencorë të paraqitur për fitimin e titullit;

b) Ka realizuar si autor i parë, së paku, 5 (pesë) referime, nga të cilat, së paku 2 (dy) janë mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres) në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuara në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në "*Proceedings*", të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.

5. Kur kandidati paraqet monografi, e cila përmbush kriteret e mëposhtme, ai përjashtohet nga detyrimet e përcaktuara në shkronjën "a", të pikës 4, të këtij kreu, sipas ekuivalentimit që vijon:

a) Botimi i 1 (një) monografie shkencore, e botuar pas fitimit të gradës shkencore "Profesor i Asociuar" brenda ose jashtë vendit, e cila duhet të përmbushë kushtet e origjinalitetit dhe duhet të jetë vlerësuar në përmbajtje si punim shkencor nga, të paktën, 2 (dy) vlerësues të pavarur të fushës kërkimore-shkencore dhe të jetë pranuar nga njësia bazë, që mbulon fushën e kërkimit.

Monografia shkencore e botuar jashtë vendit, konsiderohet e vlefshme, nëse shtëpia botuese është e rankuar nga *SENSE Ranking of Academic Publishers*, në kategorinë A, B, C ose D. Monografitë konsiderohen të ndryshme ndërmjet tyre kur ndryshojnë në përmbajtje me, të paktën, 70%. Monografia e botuar brenda vendit duhet të jetë e vlerësuar në përmbajtje si punim shkencor nga, të paktën, 2 (dy) "profesorë" të fushës kërkimore-shkencore, nga të cilët, të paktën njëri prej tyre duhet të jetë nga vendet e BE-së, OECD-së ose G20-ës;

b) Monografia e botuar brenda vendit ekuivalentohet me:

i) 2 (dy) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore brenda vendit;

ii) 1 (një) artikull shkencor, të botuar në revistë shkencore ndërkombëtare me faktor impakti.

c) Monografia e botuar jashtë vendit ekuivalentohet me:

i) 4 (katër) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore brenda vendit;

ii) 2 (dy) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore ndërkombëtare me faktor impakti.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
REKTORATI-SEKRETARIA

6. Për efekt të promovimit akademik, institucionet e arsimit të lartë marrin në konsideratë angazhimin dhe pjesëmarrjen e kandidatit, pas fitimit të titullit akademik "profesor i associuar", në:

a) komitete shkencore apo redaktuese;

b) veprimtari vlerësuese si anëtar komiteti shkencor apo redaktues, për llogari të periodikëve ose joperiodikëve shkencorë;

c) projekte kërkimore-shkencore në nivel drejtuesi, koordinatori ose anëtari;

ç) përfitimin e financimeve me bazë konkurrimi në nivel kombëtar e ndërkombëtar;

d) projekte të financuara nga programe me donatorë të huaj, të cilat sjellin përfitime për institucionin,

në rolin e koordinatorit të projektit;

dh) vlerësimet e projekteve kërkimore kombëtare ose ndërkombëtare;

e) si drejtues në komitetet organizuese të konferencave shkencore kombëtare ose ndërkombëtare;

ë) projektet e transferimit teknologjik të patentave.

7. Angazhimi dhe pjesëmarrja e kandidatit në një ose disa veprimtari të përcaktuara në pikën 5, të këtij kreu, mund të ekuivalentohet me:

a) 1 (një) artikull shkencor, të botuar në revistë shkencore ndërkombëtare me faktor impakti;

b) 1 (një) artikull shkencor, të botuar në revistë shkencore brenda vendit, dhe 2 (dy) referime të mbajtura në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres) në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuara në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në "*Proceedings*", të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.

8. Niveli sasior i treguesve të përcaktuar në pikën 6, të këtij kreu, si dhe vlera përkatëse e tyre parashikohen në rregulloren përkatëse të IAL-ve dhe vendosen në funksion të prioriteteve akademike e strategjike të tyre. Raporti për angazhimin dhe pjesëmarrjen për veprimtaritë e parashikuara në pikën 6, të këtij kreu, hartohet nga njësia bazë e njësia kryesore dhe miratohet nga Komisioni për Promovimin e Personelit Akademik.

9. Për fitimin e titullit akademik "Profesor", botimet shkencore të vlefshme janë ato të realizuara pas mbrojtjes së titullit akademik "Profesor i asociuar" deri në datën e dorëzimit të dosjes së aplikimit për titullin akademik "Profesor".

**Neni 11**

**Afatet e aplikimit**

Pas paraqitjes së kërkesës dhe dokumentacionit përkatës të aplikantëve për fitimin e titujve "Profesor" dhe "Profesor i asociuar", njësia bazë ka 20 ditë afat për ta vlerësuar atë dhe drejtuesi i njësisë kryesore ka 45 ditë në dispozicion për t'ia përcjellë atë Senatit Akademik të Universitetit të Tiranës.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
REKTORATI-SEKRETARIA

Senati Akademik ka 20 ditë në dispozicion për t'ia përcjellë atë Komisionit të Promovimit të Personelit Akademik (KPPA) dhe kjo e fundit ka në dipozicion 30 ditë për të vlerësuar plotësinë ose jo të dokumentacionit. Në rast se dokumentacioni ka mangësi, atëherë aplikantit i jepen 15 ditë kohë për plotësimin e tij.

## Neni 12

## Struktura ndihmëse e Komisionit

1. Për organizimin e procesit të punës dhe mbështetjen e Komisionit, në realizimin e funksioneve të tij, caktohet sekretaria e komisionit, e cila përbëhet nga një ose disa punonjës me kohë të plotë, kryen veprimtarinë administrative të Komisionit dhe është në vartësi të Kryetarit të Komisionit.
2. Sekretaria e Komisionit pranon kërkesat dhe dokumentacionin e dosjeve të kandidatëve dhe bën listimin e dokumentacionit të paraqitur dhe i paraqet një relacion me shkrim kryetarit të Komisionit.
3. Sekretaria e Komisionit përgatit, sipas udhëzimeve të Kryetarit:
   - mbledhjen e Komisionit,
   - bën njoftime për rendin e ditës dhe orën e mbledhjes, të paktën 48 orë para mbledhjes, - merr masa për zhvillimin e mbledhjeve,
   - mban procesverbalin në mbledhjen e Komisionit dhe në takime të tjera pune që thërret Kryetari,
   - përgatit mbledhjet e grupeve të punës që ngrihen nga Komisioni për probleme të veçanta.

## Neni 13

## Mbledhjet e Komisionit

1. Kryetari vendos për datën dhe orën e mbledhjeve të radhës, përveç rasteve kur vetë Komisioni ka vendosur ndryshe.

2. Çdo ndryshim në rendin e ditës, datën dhe orën e vendosur për mbledhjet i njoftohet, të paktën 48 orë përpara datës së mbledhjes, çdo anëtari nga sekretaria, në mënyrë që të njihet me këto ndryshime.

3. Mbledhja e Komisionit zhvillohet kur janë të pranishëm jo më pak se 2/3 e anëtarëve. Kur në hapjen e mbledhjes nuk plotësohet ky *quorum*, kryetari i Komisionit vendos thirrjen e mbledhjes një ditë tjetër.

4. Në mbledhjet e Komisionit shqyrtohen dosjet e aplikanteve, plotësia e tyre. Pasi dëgjohet raporti i dy referentëve dhe diskutohet mbi përmbajtjen e dosjes së aplikantit, Komisioni vlerëson nëse dosja e paraqitur i përmbush kërkesat e legjislaciont në fuqi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI I TIRANËS REKTORATI-SEKRETARIA

## Neni 14

## Thirrja e mbledhjeve të Komisionit

1. Lajmërimet për thirrjen e mbledhjeve bëhen nëpërmjet postës elektronike, të paktën 96 orë përpara datës së thirrjes së mbledhjes, si edhe njoftimeve nëpërmjet telefonit.
2. Lajmërimi për thirrjen e një mbledhjeje do të tregojë në mënyrë të qartë dhe të detajuar çështjet për të cilat do të diskutohet.

## Neni 15

## Rendi i ditës

1. Kryetari vendos për rendin e ditës së çdo mbledhjeje. Rendi i ditës mund të përfshijë çështje të propozuara nga të paktën 5 anëtarë të Komisionit.

2. Kërkesa për të futur një çështje në rendin e ditës duhet të bëhet nëpërmjet postës elektronike, të paktën 72 orë para datës së vendosur për mbledhje.

3. Rendi i ditës, së bashku me dokumentacionin shoqërues, duhet t'u shpërndahet të gjithë anëtarëve, nëpërmjet postës elektronike, të paktën 48 orë përpara datës dhe kohës së mbledhjes.

## Neni 16

## Marrja e vendimeve

1.Komisioni merr vendime për çështjet që janë përfshirë në rendin e ditës ose për çështje shtesë, të miratuara paraprakisht.

2.Vendimi për dhënien e titullit "Profesor" dhe "Profesor i Asocuar", merren me shumicën absolute të votave të anëtarëve të komisionit me votim të hapur.

3.Në rastet kur kemi numër të barabartë votash, vota e kryetarit të Komisionit është përcaktuese dhe shprehet në vendim .

## Neni 17

## Procesverbali i mbledhjes

1. Në çdo mbledhje mbahet një procesverbal, ku bëhet një paraqitje e të gjitha çështjeve të diskutuara në mbledhje: data dhe vendi i mbledhjes, anëtarët që morën pjesë, vendimet që u morën, si dhe forma dhe rezultati i votimeve.
2. Anëtarët e Komisionit mund të kërkojnë që të shënohen në procesverbal fakti dhe arsyet e votimit kundër një vendimi të marrë nga Komisioni.

REPUBLIKA E SHQIPERISË UNIVERSITETI I TIRANËS REKTORATI-SEKRETARIA

3. Çdo anëtar i Komisionit ka të drejtë të regjistrojë në procesverbal mosaprovimin e tij ose mendimin kundër mbi argumente të veçanta, si edhe të kërkojë përfshirjen e një deklarimi të bërë gjatë mbledhjes, të cilin e përgatit me shkrim.
4. Secili nga anëtarët e Komisionit mund të kërkojë të njihet me procesverbalin e mbajtur, i cili pasqyron qartë dhe me transparencë atë çka ndodh në mbledhje, duke pasqyruar edhe mendimet pro apo kundër të anëtarëve të Komisionit.
5. Procesverbali mbahet në përgjegjësinë e sekretarisë së Komisionit. Ai duhet të firmoset nga anëtarët pjesëmarrës në mbledhjen përkatëse, duke konfirmuar edhe pjesëmarrjen e tyre.

## Neni 18

## Administrimi i dokumentacionit të aplikantit

1. Aplikanti i dorëzon personalisht drejtuesit të njësisë kryesore kërkesën dhe dokumentacionin. Drejtuesi i njësisë kryesore ia përcjell për vlerësim dosjen drejtuesit të njësisë bazë. Pas kësaj, dokumentacioni i përcillet Senatit Akademik të UT-së .

2. Dokumentacioni i aplikantit duhet të përmbajë dokumentet që provojnë përmbushjen e kritereve të përcaktuara për standardet për fitimin e titullit akademik të kërkuar. Aplikanti dorëzon dokumentacionin në format hardcopy dhe format elektronik.

3. Dosja e aplikantit përmban vetëm aktivitetin nga data e mbrojtjes se gradës "Doktor" deri në datën e marrjes së vërtetimit të aplikimit.

## Neni 19

## Procedura e ankimit të vendimit nga aplikantët

1. Çdo aplikant gëzon të drejtën e ankimit ndaj vendimeve të ndërmjetme të Komisionit të Promovimit të Personelit Akademik (KPPA), në lidhje me porocedurat e ndjekura nga ky komision, deri para daljes së vendimit përfundimtar të Komisionit.

2. Në përfundim të rishqyrtimit, formulohet një vendim i ri, i cili është i formës përfundimtare nga ana e Komisionit.

3. Në rast refuzimi të kërkesës për fitimin e titullit akademik nga Komisioni për Promovimin e Personelit Akademik, kandidatit i lind e drejta të ripërsërisë kërkesën pas një periudhe kohore jo më të shkurtër se 2 (dy) vite nga data e paraqitjes së kërkesës së mëparshme, pranë drejtuesit të njësisë kryesore.

## Neni 20

## Hyrja në fuqi, zbatimi dhe ndryshimi i rregullores



REPUBLIKA E SHQIPERISE UNIVERSITETI I TIRANES REKTORATI SEKRETARIA

1. Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit të saj.
2. Të drejtën e ndryshimeve në këtë rregullore e ka vetëm Komisioni i Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik, pranë Senatit Akademik të UT-së .
3. Propozimet për ndryshime mund të vijnë edhe nga Rektorati i UT-së, Njësitë Kryesore, Njësitë Bazë apo anëtarët e Komisionit të Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik .

**Dispozita tranzitore**

1. Kjo rregullore zbatohet për të gjitha aplikimet e bëra, që nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqiperisë" dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.112, datë 23.02.2018 "Për përcaktimin e kritereve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë "Profesor i asocuar" dhe "Profesor".



REPUBLIKA E SHQIPERISË UNIVERSITETI I TIRANËS REKTORATI-SEKRETARIA

| Aktiviteti dhe standardet | Referenca rregullatore | Kërkesat për fitimin e titullit "Profesor" | Dokumentet që paraqiten | Realizimi |
|---|---|---|---|---|
| 1. Kategoria | VKM Nr. 112, datë 23.2.2018, Kreu III, 2. | Personeli akademik, i cili ka titullin akademik "Profesor i asociuar", aplikon për fitimin e titullit akademik "Profesor", të paktën, 5 (pesë) vite pas fitimit të titullit akademik "Profesor i asociuar". | Dokumenti që vërteton se aplikanti zotëron titullin "Profesor i asociuar" prej të paktën 5 vjetësh. | |
| 2. Roli i titullarit të lëndës/modulit dhe udhëheqësit shkencor | VKM Nr. 112, datë 23.2.2018, Kreu II, 3. a. | Personeli akademik me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme, që aplikon për titullin akademik "Profesor", duhet:<br>a) të ketë qenë titullar lënde ose moduli dhe udhëheqës i veprimtarisë shkencore për një periudhë jo më të shkurtër se 5 (pesë) vite akademike; | Dokumenti që vërteton angazhimin si titullar lënde/moduli dhe udhëheqës i veprimtarisë shkencore. | |
| 3. Lektrimi, përvoja në rolet akademike, udhëheqje doktoraturash, zotërimi i gjuhëve | VKM Nr. 112, datë 23.2.2018, Kreu III, 3. b. | 3.a. Personeli akademik me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme, që aplikon për titullin akademik "Profesor", duhet:<br>b) të jetë ose të ketë qenë i punësuar si personel akademik me kohë të plotë si lektor për një periudhë 8-vjeçare (tetëvjeçare) akademike, pas fitimit të gradës shkencore "Doktor", ose me kohë të pjesshme, si lektor, për një periudhë 12-vjeçare (dymbëdhjetëvjeçare) akademike pas fitimit të gradës shkencore "Doktor". | Vërtetimi i përvojës minimale 8-vjeçare si personel akademik me kohë të plotë, lektor, me ose pa ndërprerje ose me kohë të pjesshme për 12 vjet pas fitimit të gradës "Doktor". | |
| | VKM Nr. 112, datë 23.2.2018, Kreu III, 3. c. | 3.b. Personeli akademik me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme, që aplikon për titullin akademik "Profesor", duhet:<br>c) të ketë udhëhequr, të paktën, 2 (dy) doktorata, të përfunduara. Në rast se kandidati ka ushtruar veprimtarinë e tij akademike shkencore pranë një njësie kryesore me më pak se 40 (dyzet) veta personel akademik me kohë të plotë, në momentin e aplikimit të ketë udhëhequr, të paktën, 1 (një) doktoratë të përfunduar. | Vërtetimi i udhëheqjes të paktën i 2 doktoraturave të përfunduara.<br><br>Dokument që vërteton se kandidati ka udhëhequr 1 doktoraturë, në një institucion me deri 40 punonjës akademikë. | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | VKM Nr. 112, datë 23.2.2018, Kreu III, 3. ç. | Personeli akademik me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme, që aplikon për titullin akademik "Profesor", duhet:<br>ç) të jetë i aftë të mbajë leksione në një nga pesë gjuhët e Bashkimit Evropian: angleze, frënge, gjermane, italiane, spanjolle ose të mbrojë veprimtarinë kërkimore-shkencore përpara *Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik* në një nga këto gjuhë, në përputhje me statutin dhe rregulloren e IAL-së. | Dokumentimi i zotërimit të gjuhës së huaj (angleze, frënge, gjermane, italiane, spanjolle)<br>Ose të mbrojë veprimtarinë kërkimore-shkencore përpara KPPA-së në një nga ato gjuhë. | |
| 4. Zotërim të plotë i fushës së tij kërkimore: botimet & referimet | VKM Nr. 112, datë 23.2.2018, Kreu IV, 4. a. | 4.a. Personeli akademik, i cili aplikon për titullin "Profesor", duhet të shfaqë zotërim të plotë të fushës së tij kërkimore, e cila reflektohet në realizmin e detyrimeve, si më poshtë vijon:<br>a) Ka botuar, së paku, 7 (shtatë) artikuj shkencorë, të botuar në revista shkencore, brenda vendit ose ndërkombëtare të indeksuara. Së paku, 3 (tre) prej artikujve të jenë botuar në revista shkencore ndërkombëtare me faktor impakti, të rankuara nga *Thomson Reuters* dhe/ose *Scopus*. Kur këta artikuj janë në bashkautorësi, kandidati duhet të jetë autor i parë ose i dytë. Kandidati duhet të jetë autor i parë në, të paktën, 4 (katër) artikuj shkencorë të paraqitur për fitimin e titullit; | Dokumentimi i 7 (së paku) artikujve shkencorë të botuar në revista të indeksuara;<br>Dokumentimi i 3 artikujve të botuar në revista ndërkombëtare me faktor impakti dhe të rankuara në TR/Scopus. (linku ose një dokument që provon faktorin e impaktit të revistës në kohën e botimit);<br>Bashkautorë: autor i parë ose i dytë;<br>Dokumentimi i renditjes si autor i parë në 4 artikuj (së paku). | |
| | VKM Nr. 112, datë 23.2.2018, Kreu IV, 4. b. | 4.b. Personeli akademik, i cili aplikon për titullin "Profesor", duhet të shfaqë zotërim të plotë të fushës së tij kërkimore, e cila reflektohet në realizmin e detyrimeve, si më poshtë vijon:<br>b) Ka realizuar si autor i parë, së paku, 5 (pesë) referime, nga të cilat, së paku 2 (dy) janë mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres) në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuara në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në "Proceedings", të indeksuar me kod ISBN ose ISSN. | Dokumentimi i renditjes si autor i parë në 5 referime (së paku);<br>Dokumentimi i 2 referimeve në aktivitetin (simpozium, konferencë, kongres) në vende të BE, OECD, G20;<br>Dokumentimi i vlerësimit paraprak dhe i botimit në | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | "Proceedings", të indeksuar me kod ISBN ose ISSN. | |
| 5. Monografitë dhe ekuivalentimi | VKM Nr. 112, datë 23.2.2018, Kreu III, 5. a. | 5. Kur kandidati paraqet monografi, e cila përmbush kriteret e mëposhtme, ai përjashtohet nga detyrimet e përcaktuara në shkronjën "a", të pikës 4, të këtij kreu, sipas ekuivalentimit që vijon:<br>a) Botimi i 1 (një) monografie shkencore, e botuar pas fitimit të gradës shkencore "Profesor i asociuar" brenda ose jashtë vendit, e cila duhet të përmbushë kushtet e origjinalitetit dhe duhet të jetë vlerësuar në përmbajtje si punim shkencor nga, të paktën, 2 (dy) vlerësues të pavarur të fushës kërkimore-shkencore, dhe të jetë pranuar nga njësia bazë, që mbulon fushën e kërkimit. Monografia shkencore e botuar jashtë vendit konsiderohet e vlefshme nëse shtëpia botuese është e rankuar nga *SENSE Ranking of Academic Publishers*, në kategorinë A, B, C ose D. Monografitë konsiderohen të ndryshme ndërmjet tyre kur ndryshojnë në përmbajtje me, të paktën, 70%. Monografia e botuar brenda vendit duhet të jetë e vlerësuar në përmbajtje si punim shkencor nga, të paktën, 2 (dy) profesorë të fushës kërkimore-shkencore, nga të cilët, të paktën njëri prej tyre duhet të jetë nga vendet e BE-së, OECD-së ose G20-ës. | Dokumentimi i 1 monografie të botuar pas mbrojtjes së titullit "Profesor i asociuar", e cila të jetë origjinale, të vlerësuar nga dy vlerësues të pavarur, të pranuar nga njësia bazë;<br>Vërtetimi se monografia e botuar jashtë është e rankuar në SENSE RAP, A/B/C/D;<br>Dokumentimi i përputhmërisë deri në 30% për njohjen e një monografie të dytë;<br>Vërtetimi se monografia e botuar brenda është e vlerësuar nga 2 profesorë, njëri nga vendet e BE, OECD, G20. | |
| | VKM Nr. 112, datë 23.2.2018, Kreu III, 5, b, c. | 5. Kur kandidati paraqet monografi, e cila përmbush kriteret e mëposhtme, ai përjashtohet nga detyrimet e përcaktuara në shkronjën "a", të pikës 4, të këtij kreu, sipas ekuivalentimit që vijon:<br>b) Monografia e botuar brenda vendit ekuivalentohet me:<br>i) 2 (dy) artikuj shkencorë, të botuar në revista shkencore brenda vendit;<br>ii) 1 (një) artikull shkencor, të botuar në revistë shkencore ndërkombëtare me faktor impakti.<br><br>c) Monografia e botuar jashtë vendit ekuivalentohet me: | Raporti i njësisë bazë konfirmon, përcjellë nga njësia kryesore për ekuivalentimin sipas pikës 4. | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | i) 4 (katër) artikuj shkencorë, të botuar në revista shkencore brenda vendit, ose;<br>ii) 2 (dy) artikuj shkencorë, të botuar në revista shkencore ndërkombëtare me faktor impakti. | | |
| 6. Angazhimi dhe aktiviteti i aplikantit, pas fitimit të titullit "Profesor i asociuar" | VKM Nr. 112, datë 23.2.2018, Kreu III, 6, a-ë. | 6.a. Për efekt të promovimit akademik, institucionet e arsimit të lartë marrin në konsideratë angazhimin dhe pjesëmarrjen e kandidatit, pas fitimit të titullit akademik "Profesor i asociuar", në:<br>a) komitete shkencore apo borde editoriale;<br>b) veprimtari vlerësuese si anëtar komiteti shkencor apo bordi editorial, për llogari të periodikëve ose jo periodikëve shkencorë;<br>c) projekte kërkimore-shkencore në nivel drejtuesi, koordinatori ose anëtari;<br>ç) përfitimin e financimeve me bazë konkurrimi në nivel kombëtar e ndërkombëtar;<br>d) projekte të financuara nga programe me donatorë të huaj, të cilat sjellin përfitime për institucionin, në rolin e koordinatorit të projektit;<br>dh) vlerësimet e projekteve kërkimore kombëtare ose ndërkombëtare;<br>e) si drejtues në komitetet organizuese të konferencave shkencore kombëtare ose ndërkombëtare;<br>ë) projektet e transferimit teknologjik të patentave. | Vërtetimi i anëtarësisë në komitete shkencore apo borde editoriale;<br>Vërtetimi i pjesëmarrjes në veprimtari vlerësuese si anëtar komiteti ose bordi editoriale;<br>Vërtetimi i pjesëmarrjes në projekte kërkimore-shkencore në nivel drejtuesi, koordinatori ose anëtari;<br>Vërtetimi i përfitimit të financimeve me konkurrim në nivel kombëtar e ndërkombëtar;<br>Vërtetim i angazhimit në rolin e koordinatorit të projektit të financuar nga programe me donatorë të huaj, të cilat sjellin përfitime për institucionin;<br>Vërtetimi i qenies vlerësues për projekte kërkimore kombëtare ose ndërkombëtare;<br>Vërtetimi i angazhimit si drejtues në komitetet organizuese të konferencave shkencore kombëtare ose ndërkombëtare; | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | Vërtetimi i pjesëmarrjes në projektet e transferimit teknologjik të patentave. | |
| 7. Ekuivalentimi nga KPPA-ja i angazhimit dhe i pjesëmarrjes së aplikantit në veprimtaritë e pikës 6 | VKM Nr. 112, datë 23.2.2018, Kreu III, 7, a.<br><br>VKM Nr. 112, datë 23.2.2018, Kreu III, 7, b.<br><br>VKM Nr. 112, datë 23.2.2018, Kreu III, 8 | 7.a. Angazhimi dhe pjesëmarrja e kandidatit në një ose disa veprimtari të përcaktuara në pikën 5, të këtij kreu, mund të ekuivalentohet me:<br>a) 1 (një) artikull shkencor, të botuar në revistë shkencore ndërkombëtare me faktor impakti.<br><br>7.b. Angazhimi dhe pjesëmarrja e kandidatit në një ose disa veprimtari të përcaktuara në pikën 5, të këtij kreu, mund të ekuivalentohet me:<br>b) 1 (një) artikull shkencor, të botuar në revistë shkencore brenda vendit, dhe<br>2 (dy) referime të mbajtura në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres) në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuara në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në "Proceedings", të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.<br><br>8. Niveli sasior i treguesve të përcaktuar në pikën 6, të këtij kreu, si dhe vlera përkatëse e tyre parashikohen në rregulloren përkatëse të IAL-ve dhe vendosen në funksion të prioriteteve akademike e strategjike të tyre. Raporti për angazhimin dhe pjesëmarrjen për veprimtaritë e parashikuara në pikën 6, të këtij kreu, hartohet nga njësia bazë e njësia kryesore dhe miratohet nga *Komisioni për Promovimin e Personelit Akademik*. | Raporti i njësisë bazë, që konfirmon angazhimin në veprimtaritë e parashikuara në pikën 7 dhe në zbatim të kushtëzimeve të pikës 6. | |
| 8. Vlefshmëria e aktivitetit | VKM Nr. 112, datë 23.2.2018, Kreu III, 9. | 8. Për fitimin e titullit akademik "Profesor", botimet shkencore të vlefshme janë ato të realizuara pas mbrojtjes së titullit akademik "Profesor i asociuar" deri në datën e dorëzimit të dosjes së aplikimit për titullin akademik "Profesor". | Dokumentimi i aktivitetit shkencor si të vlefshëm brenda 2 datave limit. | |

| Aktiviteti dhe standardet | Referenca rregullatore | Kërkesat për fitimin e titullit "Profesor i asociuar" | Dokumentet që paraqiten | Realizimi |
|---|---|---|---|---|
| 1. Kategoria | VKM Nr. 112, datë 23.2.2018, Kreu II, 2. | 1. Aplikimet për fitimin e titullit akademik "Profesor i asociuar" kryhen nga anëtarët e personelit akademik të kategorisë "Lektor". | Dokumenti që vërtetohet nga drejtuesi i njësisë kryesore se aplikanti është i kategorisë "Lektor". | |
| 2. Grada | VKM Nr. 112, datë 23.2.2018, Kreu II, 3. | 2. Personeli akademik i kategorisë "Lektor" aplikon për fitimin e titullit akademik "Profesor i asociuar" të paktën 5 (pesë) vjet nga data që ka mbrojtur gradën shkencore "Doktor". | Dokumentimi i zotërimit të gradës "Doktor" prej së paku pesë vjetësh nga data e mbrojtjes në juri. | |
| 3. Lektrimi, përvoja në rolet akademike, zotërimi i gjuhëve | Lektrimi:<br>VKM Nr. 112, datë 23.2.2018, Kreu II, 4. a. | 3.a. Personeli akademik me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme, që aplikon për titullin "Profesor i asociuar", duhet të ketë zhvilluar një cikël të plotë leksionesh për, së paku, një lëndë, për 3 (tri) vite akademike. | Vërtetimi i zhvillimit të një cikli të plotë leksionesh, të paktën për një lëndë për tri vite akademike. | |
| | VKM Nr. 112, datë 23.2.2018, Kreu II, 4. b. | 3.b. Personeli akademik me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme, që aplikon për titullin "Profesor i asociuar", duhet:<br>b) të ketë përvojë pune si personel akademik me kohë të plotë për një periudhë, së paku, 5-vjeçare (pesëvjeçare), me apo pa ndërprerje ose me kohë të pjesshme si lektor, për një periudhë 8-vjeçare (tetëvjeçare) akademike, me apo pa ndërprerje, pas fitimit të gradës shkencore "doktor". | Vërtetimi i përvojës minimale 5-vjeçare si personel akademik me kohë të plotë me ose pa ndërprerje ose me kohë të pjesshme për 8 vjet me ose pa ndërprerje pas fitimit të gradës "Doktor". | |
| | VKM Nr. 112, datë 23.2.2018, Kreu II, 4. c. | 3.c. Personeli akademik me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme, që aplikon për titullin "Profesor i asociuar", duhet:<br>c) të jetë i aftë të mbajë leksione në një nga pesë gjuhët e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian: angleze, frënge, | Vërtetimi i zotërimit të njërës (të paktën) nga 5 gjuhët e BE-së (angleze, frënge, gjermane, italiane, spanjolle) ose në mungesë të vërtetimit ta | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Statuti I UT/ Rregullorja | gjermane, italiane, spanjolle ose të mbrojë veprimtarinë kërkimore botuese përpara *Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik*, në një nga gjuhët e mësipërme, në përputhje me statutin dhe rregulloren e IAL-së. | mbrojë punën kërkimore para KPPA-së në një nga gjuhët e mësipërme. | |
| 4. Zotërim të plotë i fushës së tij kërkimore: botimet & referimet | VKM Nr. 112, datë 23.2.2018, Kreu II, 5. a. | 4.a. Personeli akademik, që aplikon për titullin "Profesor i asociuar", duhet të shfaqë zotërim të plotë të fushës së tij kërkimore, e cila reflektohet në realizimin e detyrimeve të mëposhtme:<br>a) Ka botuar, së paku, 5 (pesë) artikuj shkencorë në revista shkencore brenda vendit ose ndërkombëtare të indeksuara. Së paku, 2 (dy) prej artikujve të jenë botuar në revista ndërkombëtare me faktor impakti, të rankuara nga Thomson Reuters dhe/ose Scopus. Kur këta artikuj janë në bashkautorësi, kandidati duhet të jetë autor i parë ose i dytë. Kandidati duhet të jetë autor i vetëm ose i parë në, të paktën, 2 (dy) artikuj shkencorë të paraqitur për fitimin e titullit. | Dokumentimi i 5 (së paku) artikujve të botuar te indeksuar;<br>Dokumentimi i 2 artikujve të botuar në revista ndërkombëtare me faktor impakti (linku ose një dokument që provon faktorin e impaktit të revistës në kohën e botimit);<br>Bashkautor: autor i parë ose i dytë;<br>Dokumentimi i renditjes si autor i parë në 2 artikuj (së paku). | |
| | VKM Nr. 112, datë 23.2.2018, Kreu II, 5. b. | 4.b. Personeli akademik, që aplikon për titullin "Profesor i asociuar", duhet të shfaqë zotërim të plotë të fushës së tij kërkimore, e cila reflektohet në realizimin e detyrimeve të mëposhtme:<br>b) Ka realizuar si autor i parë, së paku, 5 (pesë) referime, nga të cilat, së paku, 2 (dy) të jenë mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres) në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuara në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në "Proceedings", të indeksuar me kod ISBN ose ISSN. | Dokumentimi i renditjes si autor i parë në 5 referime (së paku);<br>Dokumentimi i 2 referimeve në aktivitetin (simpozium, konferencë, kongres) në vende të BE, OECD, G20 dhe te publikuara. | |
| | VKM Nr. 112, datë | 5.a. Kur kandidati paraqet monografi, e cila përmbush kriteret e mëposhtme, ai përjashtohet nga detyrimet e përcaktuara në | Dokumentimi i 1 monografie të botuar pas mbrojtjes së gradës | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 5. Monografitë dhe ekuivalentimi | 23.2.2018, Kreu II, 6. a. | shkronjat "a" dhe "b", të pikës 4, të këtij kreu, sipas ekuivalentimit që vijon:<br><br>a) Botimi i 1 (një) monografie shkencore, e botuar pas fitimit të gradës shkencore "Doktor", brenda ose jashtë vendit, e cila duhet të përmbushë kushtet e origjinalitetit dhe duhet të jetë vlerësuar në përmbajtje si punim shkencor nga, të paktën, 2 (dy) vlerësues të pavarur të fushës kërkimore-shkencore, dhe të jetë pranuar nga njësia bazë, që mbulon fushën e kërkimit. Monografia shkencore e botuar jashtë vendit konsiderohet e vlefshme nëse shtëpia botuese është e rankuar nga SENSE Ranking of Academic Publishers, në kategorinë A, B, C ose D. Monografitë konsiderohen të ndryshme ndërmjet tyre kur ndryshojnë në përmbajtje me, të paktën, 70%. Monografia e botuar brenda vendit duhet të jetë e vlerësuar në përmbajtje si punim shkencor nga, të paktën, 2 (dy) profesorë të fushës kërkimore-shkencore, nga të cilët, të paktën njëri prej tyre duhet të jetë nga vendet anëtare të BE-së, OECD-së ose G20-ës. | "Doktor", të vlerësuar nga dy vlerësues, të pranuar nga njësia bazë;<br><br>Vërtetimi se monografia e botuar jashtë është e rankuar në SENSE A/B/C/D;<br><br>Vërtetimi se monografia e botuar brenda është e vlerësuar nga një profesor i vendit dhe një nga vendet e BE-së, OECD-së, G20-ës. | |
| | VKM Nr. 112, datë 23.2.2018, Kreu II, 6. b. | 5.b. Kur kandidati paraqet monografi, e cila përmbush kriteret e mëposhtme, ai përjashtohet nga detyrimet e përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b", të pikës 4, të këtij kreu, sipas ekuivalentimit që vijon:<br><br>Monografia e botuar brenda vendit ekuivalentohet me:<br>i) 2 (dy) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore brenda vendit; ose<br>ii) 1 (një) artikull shkencor, të botuar në revistë shkencore ndërkombëtare me faktor impakti. | Raporti i njësisë kryesore dhe bazë konfirmon ekuivalentimin sipas pikës përkatëse. | |
| | VKM Nr. 112, datë | 5.c. Kur kandidati paraqet monografi, e cila përmbush kriteret e mëposhtme, ai përjashtohet nga detyrimet e përcaktuara në | Raporti i njësisë kryesore dhe bazë konfirmon ekuivalentimin sipas pikës përkatëse. | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | 23.2.2018, Kreu II, 6. c. | shkronjat "a" dhe "b", të pikës 4, të këtij kreu, sipas ekuivalentimit që vijon:<br><br>c) Monografia e botuar jashtë vendit ekuivalentohet me:<br><br>i) 4 (katër) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore brenda vendit; ose<br><br>ii) 2 (dy) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore ndërkombëtare me faktor impakti. | | |
| 6. Angazhimi dhe pjesëmarrja e aplikantit, pas fitimit të gradës shkencore "Doktor" | VKM Nr. 112, datë 23.2.2018, Kreu II, 7 a-ë. | 6. Për efekt të promovimit akademik, institucionet e arsimit të lartë marrin në konsideratë angazhimin dhe pjesëmarrjen e kandidatit, pas fitimit të gradës shkencore "Doktor", në:<br><br>a) komitete shkencore apo borde editoriale;<br><br>b) veprimtari vlerësuese si anëtar komiteti shkencor apo redaktues për llogari të periodikëve ose jo periodikëve shkencorë;<br><br>c) projekte kërkimore-shkencore në nivel drejtuesi, koordinatori ose anëtari;<br><br>ç) përfitimin e financimeve me bazë konkurrimi në nivel kombëtar e ndërkombëtar;<br><br>d) projekte të financuara nga programe me donatorë të huaj, të cilat sjellin përfitime për institucionin, në rolin e koordinatorit të projektit; | Vërtetimi i anëtarësisë në komitete shkencore apo borde editoriale;<br><br>Vërtetimi i pjesëmarrjes në veprimtari vlerësuese si anëtar ose borde editoriale;<br><br>Vërtetimi i pjesëmarrjes në projekte kërkimore-shkencore në nivel drejtuesi, koordinatori ose anëtari;<br><br>Vërtetimi i përfitimit të financimeve me konkurrim në nivel kombëtar e ndërkombëtar;<br><br>Vërtetimi i angazhimit në rolin e koordinatorit të projektit të financuar nga programe me donatorë të huaj, të cilat sjellin përfitime për institucionin; | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | dh) vlerësimet e projekteve kërkimore kombëtare ose ndërkombëtare;<br>e) si drejtues në komitetet organizuese të konferencave shkencore kombëtare ose ndërkombëtare;<br>ë) projektet e transferimit teknologjik të patentave. | Vërtetimi i qenies si vlerësues për projekte kërkimore kombëtare ose ndërkombëtare;<br>Vërtetimi i angazhimit si anëtar, drejtues, koordinator në projekte kërkimore-shkencore;<br>Vërtetimi i pjesëmarrjes në projektet e transferimit teknologjik të patentave. | |
| 7. Ekuivalentimi nga KPPA-ja i angazhimit dhe pjesëmarrjes së aplikantit në veprimtaritë e pikës 7. | VKM Nr. 112, datë 23.2.2018, Kreu II, 8 a-b.<br><br>VKM Nr. 112, datë 23.2.2018, Kreu II, 9. | 7. Angazhimi dhe pjesëmarrja e kandidatit në një ose disa veprimtari të përcaktuara në pikën 7, të këtij kreu, mund të ekuivalentohet me:<br>a) 1 (një) artikull shkencor, të botuar në revistë shkencore ndërkombëtare me faktor impakti, ose;<br>b) 1 (një) artikull shkencor, të botuar në revistë shkencore brenda vendit dhe 2 (dy) referime mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres), në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuara në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në "Proceedings", të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.<br><br>8. Niveli sasior i treguesve, të përcaktuara në pikën 7 të këtij kreu, si dhe vlera përkatëse e tyre parashikohen në rregulloren përkatëse të IAL-ve dhe vendosen në funksion të prioriteteve akademike e strategjike të tyre. Raporti për angazhimin dhe pjesëmarrjen për veprimtaritë e parashikuara në pikën 7 të këtij kreu hartohet nga njësia bazë e njësia kryesore dhe | Raporti i njësisë bazë, që konfirmon angazhimin në veprimtaritë e parashikuara në pikën 7 dhe në zbatim të kushtëzimeve të pikës 8. | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | miratohet nga *Komisioni për Promovimin e Personelit Akademik*. | | |
| 9. Studimet postdoktorale | VKM Nr. 112, datë 23.2.2018, Kreu II, 10. | 9. Në rastet kur kandidati ka realizuar studim postdoktoratë në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, me një kohëzgjatje, të paktën, 6 (gjashtë) muaj, shoqëruar me raport të detajuar për aktivitetin kërkimor-shkencor të zhvilluar gjatë kësaj periudhe, ai ekuivalentohet me 1 (një) artikull shkencor të botuar në revistë shkencore ndërkombëtare me faktor impakti dhe 1 (një) referim të mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres) në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuara në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në "Proceedings", të indeksuar me kod ISBN ose ISSN. | Raporti i aplikantit për studimet postdoktorale, shoqëruar dokumentacionin e lëshuar nga institucioni pritës. | |
| 10. Vlefshmëria e aktivitetit shkencor | VKM Nr. 112, datë 23.2.2018, Kreu II, 11. | 10. Për fitimin e titullit akademik "Profesor i asociuar", botimet shkencore të vlefshme janë ato të realizuara pas mbrojtjes së gradës shkencore "Doktor", deri në datën e dorëzimit të dosjes së aplikimit për titullin akademik "Profesor i asociuar". | Dokumentimi se aktiviteti shkencor është brenda 2 datave limit. | |

**RAPORT I JURISË**

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SHKENCORE**

**DHE PEDAGOGJIKE**

**TË APLIKANTIT PËR TITULLIN**

**"PROFESOR I ASOCIUAR"**

**DHE**

**"PROFESOR"**

***

## *I. Hyrje*

Baza ligjore për ngritjen e Jurise dhe rregullimin e veprimtarisë së saj.
Kur është ngritur juria (vendimi) dhe cila është përbërja e tij.
Cila është detyra e jurisë.
Përshkrim i veprimtarisë së kryer nga juria.
Përshkrim i strukturës dhe përmbajtjes së raportit në vijim, i cii i paraqitet KPPA

## *II. Raportim mbi punën e jurisë*

Përshkrim mbi takimet e jurisë, përmbajtjet e tyre dhe organizimin e punë
Përshkrim mbi dokumentacionin me të cilin punuan anëtarët
Cilat janë paraqitjet e kryera nga aplikanti, përfshirë temën kryesore
Kur është kryer njoftimi publik i paraqitjeve të aplikantit?
Përshkrim për pjesëmarrjen e anëtarëve të jurisë në paraqitjet e kryera
A u krye ekspozimi i punës nëpërmjet një njoftimi publik

## *III. Raportim mbi verifikimet e kryera në dokumentacionin e aplikantit*

Çfarë rezultoi nga verifikimi i secilit prej kritereve sipas radhës së paraqitur në VKM 112.
PS: juria verifikon që punimet shkencore të paraqitura të mos jenë publikuar para periudhës së kërkuar nga VKM dhe të mos jenë variante të ndryshuara të titujve ose të përmbajtjeve të tyre punimeve.
Karakterizim narrativ i masës së përmbushjes së kërkesave zyrtare për titullin e kërkuar.

## *IV. Raportim mbi kapacitetin për lektrim, përmbushjen e roleve akademike dhe zotërimin e gjuhëve*

Vlerësimi i aspektit pedagogjik të mbulojë çështje specifike të mjeshtërisë pedagogjike të aplikantit dhe të përfundojë me një karakterizim të përgjithshëm të arritjeve dhe përmirësimeve të pritshme në leksione dhe referatin publik

Për aplikantët për titullin "Profesor i Asociuar"

- Një përshkrim i përgjithshëm i aktivitetit pedagogjik
- Përvoja në lektrim: një cikël i plotë leksionesh
- Përvoja e punës si punonjës akademik pas fitimit të gradës "Doktor"
- Kapaciteti për të lektruar në gjuhë të huaj
- Aktivitet tjetër pedagogjik

Për aplkikantët për titullin "Profesor"

- Një përshkrim i përgjithshëm i aktivitetit pedagogjik dhe mësimdhënës
- Përvoja si personel akademik
- Titullar lënde ose moduli dhe udhëheqës i veprimtarisë shkencore
- Udhëheqje doktoraturash
- Kapaciteti për të lektruar në gjuhë të huaj
- Aktivitet tjetër pedagogjik

Në rastin kur aplikanti ofron leksion të hapur ose referim shkencor për të dëshmuar zotërimin e gjuhës së huaj, raporti mbulon çështjet që vijojnë:

Organizimi i seancave të hapura (data, pjesëmarrja nga anëtarët e jurisë)
Struktura: a është prezantuar struktura e leksionit
Metodologjia: a ka larmi metodash
Trajtimi i përmbajtjes: a trajtohen qasje dhe interpretime alternative
Ekuilibrimi metodologjik: a kombinohen metodat direktive me ato interaktive
Komunikimi me audiencën
Administrimi i kohës: a është përdorur koha në përshtatje me përmbajtjen e propozuar
Përballimi i pyetjeve dhe diskutimeve nga audienca

Raporti narrativ përshkruan në detaje edhe përmbajtjen dhe metodologjinë, si më poshtë:

Aspekti informativ
Aspekti logjik
Aspekti argumentativ
Të menduarit kritik
Nxitja e debatit
Sigurimi i vëmendjes së audiencës
Bashkëveprimi me audiencën

## *V. Raportim mbi gjetjet për zotërimin e plotë të fushës kërkimore: botimet & referimet nga aplikanti*

Për aplikantët për titullin "Profesor i Asociuar", listimi dhe një përshkrimi përmbledhës për kontributin që aplikanti ka sjell në:

Botimi i artikujve shkencorë brenda ose jashtë vendit sipas karakteristikave të kërkuara

Referimet si autor i parë në aktivitete shkencore kombëtare e ndërkombëtare sipas karakteristikave të kërkuara
Monografitë, ekuivalentimi i tyre dhe përjashtimi nga detyrimet e tjera.

Për aplikantët për titullin "Profesor", listimi dhe një përshkrimi përmbledhës për kontributin që aplikanti ka sjell në:

Botimi i artikujve shkencorë brenda ose jashtë vendit sipas karakteristikave të kërkuara
Referimet si autor i parë në aktivitete shkencore kombëtare e ndërkombëtare sipas karakteristikave të kërkuara
Monografitë, ekuivalentimi i tyre dhe përjashtimi nga detyrimet e tjera.
Raportim i udhëheqjes së doktorantëve (në rastin kur ka patur udhëheqje doktorature që kanë përfunduar) të plotësohet tabela si më poshtë:

| Nr | Autori i doktorantit | Udhëheqësi i doktorantit | Titulli i doktoraturës | Fusha e studimit | Viti i mbrojtjes | Përputhshmëria e doktoraturës me fushat e studimit të aplikantit |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | | | | | | |
| 2 | | | | | | |

Për kontributet e tjera shkencore të të dy kategorive të aplikantëve të cilat nuk specifikohen në VKM.112, referojuni shtojcës "Tipologjitë e botimi shkencor" të Akademisë së Shkencave të RSH [http://akad.gov.al/ash/pdf/Kriteret_botimeve.pdf].

## *VI. Raportim mbi angazhimin dhe aktivitetin e aplikantit, pas fitimit të gradës "Doktor" për aplikantët për titullin "Profesor i asociuar" dhe pas titullit "Profesor i Asociuar"për aplikantët për titullin "Profesor"*

Raporti përshkruan angazhimin dhe aktivitetin e aplikantit për titullin "Profesor i asociuar" dhe "Profesor" në këto drejtime: a. Pjesëmarrja e aplikantit në komitete shkencore apo borde editoriale; b) veprimtari vlerësuese si anëtar komiteti shkencor apo bordi editorial, për llogari të periodikëve ose joperiodikëve shkencorë; c) projekte kërkimore-shkencore në nivel drejtuesi, koordinatori ose anëtari; ç) përfitimin e financimeve me bazë konkurrimi në nivel kombëtar e ndërkombëtar; d) projekte të financuara nga programe me donatorë të huaj, të cilat sjellin përfitime për institucionin, në rolin e koordinatorit të projektit; dh) vlerësimet e projekteve kërkimore kombëtare ose ndërkombëtare; e) si drejtues në komitetet organizuese të konferencave shkencore kombëtare ose ndërkombëtare; ë) projektet e transferimit teknologjik të patentave.

Në raport jepet një gjykim nga ana e Jurisë mbi ekuivalentimin e realizimeve të mësipërme.

PS: Për vlerësimin e këtij angazhimi dhe veprimtarie juria bazohet në raportin që nga njësia bazë e njësia kryesore dhe vendoset nga Komisioni për Promovimin e Personelit Akademik.

## *VII. Raportim mbi studimet pasdoktorale të aplikantit.*

Raportimi i këtij zëri kryhet vetëm për aplikantët që kanë kryer studime pasdoktorale.

Raportimi bazohet në të dhënat e raportit të dorëzuar nga vetë aplikanti dhe ekuivalentohet sipas kërkesave të VKM. 112.

Raportimi mbulon zëra të tilla si: a.karakteri teorik e praktik i kërkimit, b.sasia e kërkimit të aplikantit, c.cilësia e kërkimit, d.dimensioni kombëtar e ndërkombëtar, dh.ndikimi social e profesional, e.përputhshmëria e fushës zyrtare të kërkimit me fushat e kërkimit të aplikantit.

## *VIII. Përfundime dhe rekomandim*

- Baza ligjore
- Vlerësim përmbledhës mbi përmbushjen ose jo të kërkesave për fitimin e titullit "Profesor i Asociuar"dhe "Profesor".
- Argumentimi i përmbledhur dhe zë për zë i rekomandimit të Jurisë
- Rekomandimi I Jurisë për KPPA për dhënien ose jo të titullit të kërkuar.
- Formula e rekomandimit përfundimtar pritet të jetë:

Juria e përbërë nga anëtarët e poshtëshënuar, në përfundim të procesit të vlerësimit të kërkesës së aplikantit XY për fitimin e titullit "Profesor i asociuar"/"Profesor", deklaron se aplikanti përmbush/nuk i përmbush kërkesat për marrjen e titullit të kërkuar.

Me këtë rast juria i rekomandon KPPA që të marrë në konsideratë rekomandimin e saj që aplikantit XY t'i jepet/ të mos i jepet titulli i kërkuar.

- Përbërja e jurisë, roli i secilit dhe firma e data përkatëse e vendimit të marrë në faqen e fundit, ndërsa vetëm firmat në fund të faqeve të tjera.

P.s. Ky format minimum që respektohet në mënyrë të unifikuar, nuk e pengon Jurinë të paraqesë edhe argumente të tjera në Raport.

Tiranë....../....../.........

FORMAT I RAPORTIT

PËR VLERËSIMIN E PRODUKTEVE SHKENCORE TE TIPIT MONOGRAFI

TE PARAQITURA NE KERKIM TE TITUJVE

"PROFESOR I ASOCIUAR"

DHE

"PROFESOR"

***

---

Raporti i paraqitur i cili shënon vlerësimin e monografive në mbështetje të aplikimit për titujt "Profesor i asociuar" dhe "Profesor" pritet t'i përmbahet këtij formati.

1. Vlerësimi i monografisë përshkruan plotësimin e kushteve strukturore, teknike dhe përmbajtësore.
    a. Monografia e paraqitur pritet të ketë këtë strukturë të përgjithshme: Titulli, Abstrakti, Hyrja, Metodologjia, Literatura, Rezultatet, Diskutimi, Përfundimi.
    b. Monografia pritet të jetë botuar nga një ent i besueshëm sipas akteve rregullatore, të jetë ent që boton kërkime shkencore, të jetë shoqëruar nga vlerësime të autoriteteve shkencore të fushës.
    c. Monografia pritet të jetë një vepër shkencore e cila ka për objekt një temë të rëndësishme të teorisë dhe të praktikës dhe ta mbulojë atë në thelbin dhe në të gjitha lidhjet e saj.
    d. Monografia të përmbajë të dhënat e botimit: autorin, vlerësimin shkencor, entin botues, vitin e botimit, tirazhin, etj.
2. Vlerësimi i monografisë përshkruan përgjigjet specifike dhe të qarta të autorit për pyetjet e mëposhtme:
    a. Formulimi i problemit dhe/ose i qëllimit të studimit: a ekziston një argument i fortë që studimi është i domosdoshëm, i nevojshëm, i rëndësishëm?; a bazohet ai në njohuritë ekzistuese dhe a ka një qëllim të përcaktuar?
    b. Shqyrtimi i literaturës ekzistuese: a mbështetet studimi fort në literaturë? A i shërben përdorimi i literaturës qasjes së përgjithshme të studimit? A është literatura e shqyrtuar relevante dhe më e rëndësishmja në fushë? A është literatura e përdorur e disponueshme dhe e aksesueshme?
    c. Dizajni i studimit: a është e përligjur zgjedhja e dizajnit me kampionin në studim dhe të dhënat e grumbulluara?
    d. Analiza e të dhënave: A janë grumbulluar të dhënat për studimin me metodat e duhura? A janë ato të dhënat e duhura për të dhënë përgjigje për objektivat/pyetjet kërkimore/hipotezat e studimit?
    e. Diskutimi dhe kontributi vetjak: A janë interpretimet të bazuara në të dhënat e grumbulluara dhe në logjikë? A i sintetizojnë ato të dhënat e pjesshme dhe jokonfirmuese?
    f. Përfundimi: a i merr parasysh monografia aspektet kryesore të studimit, kufizimet e tij dhe fushat për kërkim të mëtejshëm?
    g. Karakterizimi i përgjithshëm: a ka studimi monografik një paraqitje të mirë teknike, gjuhësore, kontributive?
    h. Vlerësimi i monografisë përshkruan përmbushjen e kërkesave për një vepër shkencore:
3. Vlerësimi i monografisë do të duhet të përfundojë me një karakterizim të përgjithshëm për vlefshmërinë, dobinë, rëndësinë e saj për autorin dhe fushën e kërkimit.
4. Karakterizimi i përgjithshëm: a ka studimi monografik një paraqitje të mirë teknike, gjuhësore, kontributive?
5. Vlerësimi i monografisë do të duhet të përfundojë me një rekomandim të qartë për konvertueshmërinë e saj me artikujt e kërkuar shkencorë, siç e kërkojnë aktet rregullatore.

Formulimi i problemit dhe/ose i qëllimit të studimit: a ekziston një argument i fortë që studimi është i domosdoshëm, i nevojshëm, i rëndësishëm?; a bazohet ai në njohuritë ekzistuese dhe a ka një qëllim të përcaktuar?

Shqyrtimi i literaturës ekzistuese: a mbështetet studimi fort në literaturë? A i shërben përdorimi i literaturës qasjes së përgjithshme të studimit? A është literatura e shqyrtuar relevante dhe më e rëndësishmja në fushë?

Dizajni i studimit (sasior): a është e përligjur zgjedhja e dizajnit me kampionin në studim dhe të dhënat e grumbulluara?

Analiza e të dhënave: A janë grumbulluar të dhënat për studimin me metodat e duhura? A janë ato të dhënat e duhura për të dhënë përgjigje për objektivat/pyetjet kërkimore/hipotezat e studimit?

Diskutimi dhe kontributi vetjak: A janë interpretimet të bazuara në të dhëna dhe në logjikë? A i sintetizojnë ato të dhënat e pjesshme?

Përfundimi: a i merr parasysh monografia aspektet kryesore të studimit, kufizimet e tij dhe fushat për kërkim të mëtejshëm?

Formulimi i problemit dhe/ose i qëllimit të studimit: a ekziston një argument i fortë që studimi është i domosdoshëm, i nevojshëm, i rëndësishëm?; a bazohet ai në njohuritë ekzistuese dhe a ka një qëllim të përcaktuar?

Shqyrtimi i literaturës ekzistuese: a mbështetet studimi fort në literaturë? A i shërben përdorimi i literaturës qasjes së përgjithshme të studimit? A është literatura e shqyrtuar relevante dhe më e rëndësishmja në fushë?

Dizajni i studimit (sasior): a është e përligjur zgjedhja e dizajnit me kampionin në studim dhe të dhënat e grumbulluara?

Analiza e të dhënave: A janë grumbulluar të dhënat për studimin me metodat e duhura? A janë ato të dhënat e duhura për të dhënë përgjigje për objektivat/pyetjet kërkimore/hipotezat e studimit?

Diskutimi dhe kontributi vetjak: A janë interpretimet të bazuara në të dhëna dhe në logjikë? A i sintetizojnë ato të dhënat e pjesshme?

Përfundimi: a i merr parasysh monografia aspektet kryesore të studimit, kufizimet e tij dhe fushat për kërkim të mëtejshëm?